

LIVRET D'ACCUEIL A L'ECOLE

FRANÇAIS / ALBANAIS

Libërth prezantues për shkollat fillore

Ce livret est destiné aux élèves nouvellement arrivés en France et à leurs parents

Ky libërth është i nevojshëm për fëmijët dhe prindërit e sapoardhur në Francë.

ALBANAIS

Shkolla është laike, falas dhe e obliguar për të gjithë fëmijët që banojnë në territorin francezë prej moshës 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.

Shkollimi është një e drejt dhe gjithashtu një obligim. Fëmiju juaj duhet pra me përcjellur shkollimin në mënyrë të .

Në bazë të dispozitave ligjore të artikullit L.141-5-1 mbi kodin e edukimit « nxënësit që mbajnë shenja apo veshin tesha për të manifestuar haptazi përkatësin fetare është e ndaluar ». Në rast se ndonjë nxënës nuk e respekton këtë ndalim, drejtoresha apo drejtori do të mbledhë ekipin edukativë (artikulli 21 i dekretit n°90.788 të 06/09/1990) për të organizuar një dialog me nxënësin dhe familjen e ti.

Punim i realizuar së bashku me përgjegjësen e misionit për pritjen e nxënësve të posaardhur në Francë (ENAF) dhe shërbimi për aksione sociale në përkrahje të nxënësve në inspeksionin akademik të Ain

SHKOLLIMI NË FRANCË	2
1 Funksionimi i shkollës	2
2. Pranimi dhe Regjistrimi	3
kopshti Fëmijëve	3
Shkolla Fillore.....	3
3. Shkollimi dhe obligimet shkollore	3
Kopshti i Fëmijëve	3
Shkolla Fillore.....	3
Oraret e shkollimit	3
4. Aktivitetet shkollore	4
5 Shërbimet plotësuese	4
6 Për me ditur më shumë	4
Projekti i shkollës	4
Orientimi	4
Njoftime praktike për prindërit.....	4
Komunikimi me familjet	4
Këshilli i shkollës	4
Rregullorja e mbrendshme e shkollës	5
Në rast aksidenti	5
Sigurimi	5
Adresat e nevojshme:	5

SHKOLLIMI NË FRANCË

Shkolla është laike, falazi dhe e obligueshme për të gjithë fëmijët që jetojnë në territorin francezë nga moshë 6 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare.

Mbarëvajtja në shkollë është gjithashtu punë e familjes. Sa më herët e dërgoni fëmijën e juaj në shkollë dhe sa më rregullishtë ai shkollohet aq më shumë edhe do të arrijë.

Që nga moshë 2 vjeçare, fëmiju juaj mundet të shkollohet në kopshtin e fëmijëve. Kjo varet nga vendet e lira dhe nëse fëmiju juaj është i pastërt (d.m.th. pa pelena). Në moshën 6 vjeçare fëmiju juaj fillon shkollën fillore. Shkolla fillore do të përgadisë fëmijun tuaj për të hyrë në kolegje.

Në moshën 11 vjeçare ai do të hyjë në kolegje për katër vite të shkollimit (klasa e 6, klasa e 5, klasa e 4 dhe klasa e 3).

1 Funksionimi i shkollës

Shkolla fillore	Kursët Mesatare Klasa e Dytë (C.M.2)	Cikli i 3	
	Kursët Mesatare Klasa e Parë (C.M.1)		
	Kursët Fillestare Klasa e Dytë (C.E.2)		
	Kursët Fillestare Klasa e Parë (C.E.1)	Cikli i 2	
	Kursi Përgaditorë (C.P.)		
Kopshti i Fëmijëve	Seksioni i Madhë (G.S.)	Cikli i 1	
	Seksioni i Mesëm (M.S.)		
	Seksioni i Vogël (P.S.)		
	Më të Vegjëlët (T.P.)		

Shkolla është e organizuar në tri cikle : cikli i 1, cikli i 2 dhe cikli i 3. Kohëzgjatja mesatare e një cikli është 3 vite. Por mundet të jetë 2 vite apo 4 vite. Kjo varet nga ritmi i fëmijut.

Kalimi nga një cikël në ciklin tjetër vendoset nga këshilli i mësuesve. Në rastë mospajtimit prindërit kanë mundësi të bëjnë ankesë (lujte) pranë Inspektorit të Akademisë.

2. Pranimi dhe Regjistrimi

kopshti Fëmijëve

Kjo shkollë pranon fëmijët nga mosha 2 vjeçare deri në moshë 6 vjeçare dhe varet nga vendet e

lira. Edhe nëse fëmiju juaj nuk e fletë gjuhën frenge, ai mundet të shkollohet. Drejtori (apo Drejtoresha) e shkollës që gjindet në lagjen e juaj mundet të ju njoftojë.

Shkolla Fillore

Për me e shkruajtur fëmion e juaj në shkollën fillore, ju duheni të drejtoheni tek Drejtori i shkollës që gjindet në lagjen e juaj i cili mundet të ju njoftojë. Ju duheni me prezentuar librezën e familjes për me vërtetuar identitetin e prindërve të fëmionit. Në rastë të kundërt, ju duheni me prezentuar një vërtetim juridikë i cili vërteton autoritetin e prindërit dhe librezën shëndetësore (për verifikimin e vaksinave).

3. Shkollimi dhe obligimet shkollore

Kopshti i Fëmijëve

Kopshti i Fëmijëve është vendë ku gjatë 3 ose 4 viteve fëmiju juaj do të mësojë gjuhën frenge, do të praktikojë shumë aktivitete të cilat do të lehtësojnë adaptimin e fëmionit tuaj në të gjitha lëndët e parapame dhe do të mësohet me jetën në grupë. Gjithashtu, ai do të përgaditet për shkollën fillore.

Në fillim, ju mundeni të shoqëroni fëmion e juaj deri në sallën e klasës dhe mundeni ti ndihmoni për tu përgaditur për në klasë. Cdo herë që ju dëshironi, ju mundeni të kërkonit takim me mësuesin (mësuesën) e fëmionit tuaj. Është mirë që të takoheni me të rregullishtë.

Në fundë të paraditës, fëmiju mundet të mirret vetëm nga një personë përgjegjës i caktuar nga prindërit dhe që i është prezentuar mësuesit -sës dhe drejtorit -reshës.

Regjistrimi i fëmionit në kopshtë domethënë që familja angazhohet që fëmiju do të vi në kopshtë rregullishtë. Kjo rregullësi do ti mundësojë fëmionit tuaj që të përparon personalitetin e tij dhe të përgaditet për të hyrë në shkollën fillore. Cdo vështirësi do të jetë objekt i një mbledhjeje të profesorëve që mund të propozojnë një mbajtje nën përgjegjësi specifike. Mungesat dhe mos frekuentimi I rregullt mund të vejë në rrezik shkollimin tuaj.

Shkolla Fillore

Shkolla është një e drejtë. Arsimi është i obligueshëm. Fëmiju duhet të shkojë në shkollë rregullishtë. Jeta në mesin e shkollës është e organizuar në bazë të një rregullores të mbrendshme e cila do t'ju komunikohet dhe të cilën fëmiju juaj duhet ta respektojë (oraret, lëvizjet).

Këshilli i mësuesve vendosë nivelin e shkollimit që fëmiju juaj duhet të mësojë.

Këshilli I mësuesve të shkollës do të përcaktojë klasën që do të frekuentojë fëmija. Nëse fëmija juaj vjen në Francë dhe nuk di të flasë frengjisht, ai do të regjistrohet në klasën përkatëse për moshën e tij dhe për nivelin e tij shkollor. Gjithashtu, ai do të përfitojë ndihmën e një mësuesi CRI (kurse për të kapur ritmin e gjuhës) për të mësuar gjuhën franceze. Nëse fëmija juaj haset me vështirësi të tjera specifike, shkolla do të gjejë bashkë me ju zgjidhjet më të mira të mundshme.

Një ndihmë e vecantë dhe suplementare mund ti jepet fëmijës tuaj përgjatë dy orëve cdo javë, përvec orëve të tjera të mësimin. Ajo duhet të propozohet nga profesori dhe puna bëhet në grupe të vegjël. Bëhet fjalë për dispozitën e ndihmës së personalizuar për nxënësit

Në rastë të problemeve të rëndësishëm, fëmiju mundet të pranohet në institucione të specializuara. Orientimi në këto klasë apo institucione bëhet nga një komision i cili bënë propozimit e sajë prindërve. Në disa shkolla, një ndihmë e specializuar ju ipet nxënësve që kanë nevojë.

Ju mundeni që të takoheni me mësuesin -sën e fëmionit tuaj çdo herë që të dëshironi.

Në rastë se fëmiju juaj mungon në shkollë, ju duheni me lajmëruar shkollën në telefon dhe kur të kthehet fëmiju në shkollë, ju duheni ti ipni një letër në të cilën tregoni arsyjen e mungesës. Në rastë se fëmiju është i sëmurë, ju duheni që ta mbani në shtëpi dhe kur të kthehet në shkollë të ketë me vete çertifikatën e mjekut apo një letër nga prindërit.

Oraret e shkollimit

Hyrja në shkollë

Hapja e shkollës bëhet në _____

Nxënësit nuk munden të hynë mbas orës _____ ose _____ vetëm në raste të veçanta.

Hyrja në shkollë bëhet vetëm në hyrjen _____.

Dalja nga shkolla

Në fundë të mësimit, në _____, nxënësit përcillen deri te dera e shkollës dhe prej aty vendi janë nën përgjegjësinë e prindërve. Në fillim të vitit shkollor, mësuesi do t'ju komunikojë kalendarin e shkollimit.

4. Aktivitetet shkollore

Të gjitha aktivitetet e organizuara nga shkolla ndihmojnë në zhvillimin e fëmijës dhe janë të detyrueshme.

Shkolla ka: (të plotësohet nga çdo shkollë)

- një bibliotekë qendrore të dokumentacionit (B.C.D.),
- një sallë të informatikës,
- një gjimnazë,

Për aktivitetet fizike dhe sportive një veshje e përshtatshme është e obliguar (mbadhje sportive dhe veshje praktike).

Nxënësit e klasës _____ të cilët shkojnë në bazen të notit për tu mësuar me notuar. Për këtë duheni me pasur në mënyrë të obliguar: një kostum banje, një pishkir të banjës, një kapelë të banjës dhe një sapun. Ky aktivitet është i obliguar. Vetëm mjeku mundet me e liruar përkohësisht fëmijun që të mos praktikojë aktivitetet fizike.

Në bazë të projekteve të klasës, nxënësi mundet të praktikojë: lundrim, kajak, golf, ngjitje, ski, luftime dhe aktivitete kulturore (...).

Klasa të zhvendosura munden të organizohet. Në këtë rastë, klasa do të shkojë për disa ditë në një vendë të caktuar e të ndryshëm për ti praktikuar disa aktivitete. Në rastë të organizimit të daljeve të tilla, prindërit do të njoftohen me shkrim dhe nënshkrimi i tyre është i obliguar.

5 Shërbimet plotësuese

Shërbimet e ndryshme: (të plotësohet nga çdo shkollë)

- aktivitete propozohen në kohën e drekës
- aktivitete propozohen në mbrëmje
- një pritje organizohet në shkollë në mëngjezë ➤mësime të mbrëmjes
- restoranti i shkollës punon të hënën, të martën, të enjtën, të premten kur ka mësim

- kurse të gjuhën turke, marokene
- organizohen në shkollë tjera :

6 Për me ditur më shumë

Projekti i shkollës

Cdo shkollë ka një projekt të vetin. Për të konsultuar projektin e shkollës, mund të pyesni drejtorin.

Orientimi

Në fundë të klasës CM2, nxënësit do të hynë në kolegje.

Njoftime praktike për prindërit

Komunikimi me familjet

Datat e mbledhjeve me prindërit do t'ju lajmërohen me shkrim.

Duheni me ditur se ndër të tjera tri herë në vitë prindërve i ipet libri i vlerësimit të fëmijut të vetë. Në këtë libër gjinden të gjitha vlerësimet që nxënësi ka bërë gjatë mësimit dhe çdo gjë që ka mësuar ai. Familjet (prindërit dhe fëmijët) munden me dhënë mendimin e tyre në lidhje me punën e nxënësit. Nëse keni pyetje apo ndonjë brengësi në lidhje me shkollimin e fëmijut tuaj mos ngurroni që të takoni mësuesin e tij.

Këshilli i shkollës

Cdo vitë, në mesin e muajit tetorë, bëhet zgjedhja e prindërve që do të marrin pjesë në këshillin e shkollës. Prindërit me origjinë të huaj i kanë të nejtat të drejta si prindërit francezë.

Përbërja e këshillit të shkollës : drejtori, përfaqësuesit e zgjedhur nga prindërit, kryetari i komunës, i Deleguari i Departementit për Arsimin Nacional, mësuesit e shkollës dhe personeli tjetër i cili punonë me nxënësit. Këshilli i shkollës mbledhet një herë në tre muaj.

Këshilli i shkollës voton rregulloren e mbrendshme të shkollës. Gjithashtu jepë mendimin e saj në lidhje me kushtet e funksionimit material e financiar të shkollës, kushtet e integritetit për nxënësit handikap, restaurimi shkollor, organizimi i javës shkollore dhe oraret e mësim, aktivitetet parashkollore, sigurimi i fëmijëve, të gjitha pyetjet në lidhje me jetën shkollore, organizimi i aktiviteteve protësuese edukative dhe përdorimi i lokaleve shkollore. Njoftohet për përbërjen e klasave, zgjedhja e materialeve pedagogjike dhe kushtet e takimeve në mes të prindërve dhe mësuesve.

Rregullorja e mbrendshme e shkollës

Shkruhet nga rregullorja e rrethit dhe ju ipet nga mësuesit.

Në rast aksidenti

Cdo prindër duhet të vi në shkollë ditën e parë të shkollës dhe të na jepë me shkrimë adresën dhe numrin e telefonit ku mundemi ta kontaktojmë në rast aksidenti të fëmijut (ose emrin e personit që mundet me marrë fëmijun).

Edhe nëse fëmiju lëndohet pak, ne ju lajmërojmë posa të mundemi apo kur të vini me marrë fëmijun në shkollë mbas mësim. Në rast se nuk arrimi dot t'ju kontaktojmë as ju as personin përgjegjës dhe nëse fëmiju është lënduar shumë ai dërgohet në spital nga zjarrfikësit dhe në mundësi i shoqëruar nga një mësues.

Sigurimi

Një sigurim për përgjegjësi civile ju nevojitet kur ta shkruani fëmijun e juaj në shkollë. Ky sigurim është i obliguar.

Në rast dalje në shëtitje, një sigurim plotësues është e nevojshme. Për këtë duheni të pyetni drejtorin i cili mundet të ju njoftojë.

Adresat e nevojshme:

Inspeksioni Adamemik Zyra për Pritjen e Personave që Arrinë në rrethin tonë të Ain C.R.I. (kurset për mësim të integruar)

5, rue La Fontaine

01000 Bourg-en-Bresse

☎ : 04 74 21 99 54

ce.ia01-enaf@ac-lyon.fr

Dispozitivi i pritjes për nxënësit e posaardhur në Oyonnax

Kolegji Jean Rostand

Rruga Marcel Gaget Marchon numër 5

01100 Arbent

☎ : 04.74.77.15.79

enaf.0010065r@ac-lyon.fr